

VENDIM
Nr. 373, datë 5.6.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, pikat 5/2 e 5/4, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Nënparagrafi i gjashtë, i kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:
"- objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe tregtimin e tyre."
 2. Pika 4, e nënkreut II.a, ndryshohet, si më poshtë vijon:
"4. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit në intensitetin e ndërtimit, përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Leje ndërtimi për shtesat në ndërtimet ekzistuese dhe leje për objekte të reja, miratohen nëse nuk është shteruar intensiteti, sipas planit të përgjithshëm vendor ose planit të detajuar vendor ose intensiteti, sipas përcaktimeve të këtij vendimi."
 3. Në nënkreun II.b bëhen këto ndryshime:
 - a) Në shkronjën "a", të pikës 1, vëllimi " $0.03 \text{ m}^3/\text{m}^2$ " zëvendësohet me " $3 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ";
 - b) Shkronja "b", e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:
"b) Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektohet lartësia maksimale 5.5 (pesë pikë pesë) metra, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi, për shkak të karakteristikave teknike."
 - c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:
"3. Për ndërtimin e stallave, që mbarësojnë mbi 50 (pesëdhjetë) njësi gjedhi mbi bazë, duhen të plotësohen këto kritere:
 - a) Të respektohen distancat minimale të mëposhtme:
 - i. 15 (pesëmbëdhjetë) metra nga kufijtë e pronës;
 - ii. 400 (katërqind) metra nga zonat e banuara;
 - iii. 50 (pesëdhjetë) metra nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
 - b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme, në bazë të karakteristikave të veçanta teknike, dhe lartësi maksimale 6 (gjashtë) metra në ulluk dhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) metra në kulm;
 - c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej $4 \text{ m}^3/\text{m}^2$."

Përjashtimisht, për stallat që ndërtohen me lartësi deri në 4 (katër) metra në ulluk, 6 (gjashtë) metra në kulm ose 4.5 (katër pikë pesë) metra, kur çatia është e drejtë, distanca nga prona kufitare është jo më pak se 7 (shtatë) metra. Në këto raste, vëllimi maksimal është $3 \text{ m}^3/\text{m}^2$.

 - ç) Lejet e ndërtimit për stallat dhe objektet ndihmëse miratohen vetëm nëse përmbushen kërkesat dhe kriteret e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe nuk ka shkarkime që krijojnë ndotje në ujë."
 - ç) Në pikën 7, togfjalëshi "70%" zëvendësohet me "90%";
 - d) Në shkronjën "a", të pikës 10, vëllimi " $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ " zëvendësohet me " $4 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ";

dh) Shkronja “b”, e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Të respektohen distancat minimale prej 5 (pesë) metrash nga kufijtë e pronës dhe distancat nga ndërtimet e tjera, pa cenuar funksionalitetin e tyre.”.

e) Në shkronjën “a”, të pikës 11, vëllimi “ $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ” zëvendësohet me “ $4 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ”.

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku